

20191011263

**LIGJ PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NË BANKËN
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM – BANKËN BOTËRORE
SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIM TË PROJEKTIT PËR
LEHTËSIMIN E TRGTISË DHE TRANSPORTIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR**

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet me hua në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankën Botërore në shumë prej 26.200.000 eurosh, të dedikuar për realizimin e Projektit për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua për financim të Projektit për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni do ta nënshkruajë ministri i Financave ose personi i autorizuar prej tij.

Neni 3

Afati për pagesën e huas nga neni 1 i këtij ligji është 12 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej katër vitesh.

Shkalla e kamatës është EURIBOR gjashtëmuor e rritur për shtrirje fikse.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes për hua nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji, Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore provizion të njëfishtë në shumë prej 0,25% të shumës së huas.

Republika e Maqedonisë do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore provizion të njëfishtë në shumë prej 0,25% të pjesës së patërhequr të huas në nivel vjetor.

Huaja do të paguhet në 16 këste gjysmëvjetore, secili në shumë prej 6,25% të shumës së huas.

Huaja do të paguhet më 1 maj dhe 1 nëntor çdo vit.

Neni 4

Shfrytëzues të mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji janë Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Ekonomisë, Drejtoria Doganore e Republikës së Maqedonisë dhe Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore.

Neni 5

Republika e Maqedonisë do ta paguajë huan nga neni 1 i këtij ligji nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.